

L I G J
Nr. 8691, datë 16.11.2000

PËR PRODHIMIN DHE TREGTIMIN E DUHANIT DHE TË CIGAREVE
(Ndryshuar me ligjin nr. 8809, datë 17.5.2001; nr. 8974, datë 21.11.2002; nr. 9636, datë 6.11.2006; nr. 10137, datë 11.5.2009; nr. 10275, datë 6.5.2010; nr. 65/2013, datë 14.2.2013; nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 paragrafi 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë prodhimin, tregtimin e duhanit të papërpunuar, përpunimin industrial, tregtimin e duhanit të përpunuar dhe të produkteve të tij në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Mbikëqyrja dhe kontrolli i prodhimit dhe i tregtimit të duhanit dhe të produkteve të tij realizohet nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit. Ministria e Financave, në përputhje me legjislationin në fuqi, kontrollon anën fiskale.

Neni 3

Në kuptim të këtij ligji:

“Duhan” nënkupton gjethen e bimës së kultivuar të specieve *Nicotiana tabacum*, në të gjitha format dhe stadet e rritjes, të përpunimit dhe të manipulimit, kur nuk përdoren për konsum final.

“Prodhim bujqësor i duhanit” nënkupton prodhimin e farës, të fidaneve të duhanit, rritjen e tij në fushë, vjeljen, tharjen dhe manipulimin e duhanit nga prodhuesit.

“Përpunim industrial i duhanit” nënkupton klasifikimin, manipulimin, heqjen e kërcellit për duhanet gjethemëdha, fermentimin ose trajtimin termik dhe përgatitjen e duhanit për tregtim.

“Tregtim duhani” nënkupton shitblerjen e duhanit në të gjitha fazat e prodhimit, të përpunimit deri në shpërndarjen e tij si produkt gjysmë i gatshëm (duhan i përpunuar).

“Produkte duhani” nënkupton cigaret, puretat, purot, duhanet për llullë, duhanin kaush, burnotin dhe duhanin për përtpje.

KREU II

PRODHIMI BUJQËSOR DHE TREGTIMI I DUHANIT TË PAPËRPUNUAR

Neni 4

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009)

Prodhuesit e duhanit prodhojnë gjithë duhani për treg, mbi bazën e kontratës së shkruar të prodhimit, me persona juridikë e fizikë, vendas dhe të huaj, të regjistruar si grumbullues e përpunues industrialë të duhanit në regjistrat e strukturave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në rrethe. Këto subjekte pajisen me autorizim grumbullimi nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 5

Prodhimi, kontrolli, çertifikimi dhe shpërndarja e farës së duhanit bëhet nga institucionet shkencore dhe nga ente të tjera, të njohura dhe të miratuara nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

Farërat dhe fidanet e duhanit shpërndahen nga persona juridikë dhe fizikë, të cilët përfshihen në regjistrin e grumbulluesve dhe të përpunuesve të duhanit.

Neni 6

Për prodhimin e fidaneve të duhanit përdoren vetëm farëra që janë prodhuar dhe certifikuar në përputhje me rregulloret e prodhimit të farërave bujqësore të vendit dhe të huaja dhe janë të regjistruara në katalogun zyrtar të farërave dhe të fidanëve të Republikës së Shqipërisë, pranë Entit Shtetëror të Farërave dhe të Fidanëve.

Neni 7

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit përcakton dhe miraton rajonizimin e kultivimit të nentipeve të duhanit për të gjithë vendin. Strukturat në varësi të saj bëjnë rajonizimin dhe përcaktimin e llojeve të prodhimit të duhanit, sipas kushteve agroklimate.

Neni 8

Kultivimi i duhanit kryhet sipas udhëzimeve metodike, të miratuara nga institucionet shkencore përkatëse, të cilat përgatiten në përshtatje me kërkesat ekzistuese, që sigurojnë ruajtjen e mjedisit dhe pastërtinë e prodhimit të duhanit.

Neni 9

1. Prodhuesit e duhanit, çdo fillim viti, brenda datës 31 maj, bëjnë deklaratën me shkrim, në strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në rreth, me të dhënat faktike për vendin e prodhimit, sipërfaqen, tipin, llojin dhe prodhimin e pritshëm të duhanit.

2. Pranë këtyre strukturave mbahet regjistri i prodhuesve të duhanit dhe i sipërfaqeve të kultivuara me duhan.

Neni 10

Vlerësimi cilësor i duhanit kryhet nga prodhuesi, grumbulluesi dhe/ose përpunuesi industrial i duhanit, mbështetur në standardet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Prodhuesit e duhanit, grumbulluesit dhe përpunuesit industrialë të tij i rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre, duke lidhur kontratat përkatëse të prodhimit dhe të tregtimit të duhanit, të cilat, paraprakisht, nënshkruhen dhe/ose për prodhimin e ardhshëm sezonal.

Neni 12

Nga prodhuesit duhani tregtohet i tharë, i manipuluar në dengje fshati.

Neni 13

Të dhënat për duhanin e shitur, në sasi dhe vlerë, deklarohen nga grumbulluesit dhe regjistrohen në regjistrin e strukturave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në rrethet përkatëse.

KREU III PËRPUNIMI INDUSTRIAL DHE PRODHIMI I PRODUKTEVE TË DUHANIT

Neni 14

(Ndryshuar me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009)

1. Veprimtaritë e përpunimit industrial dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.

2. Licenca, sipas pikës 1 të këtij neni, u jepet subjekteve, që plotësojnë kushtet teknike dhe teknologjike për përpunimin industrial dhe/ose prodhimin e produkteve të duhanit ose që kanë kontratë për përpunim industrial dhe/ose prodhim të produkteve të duhanit, me subjekte, që plotësojnë kushtet e mësipërme, me të drejtë ripërsëritjeje.

Neni 15

Prodhuesit dhe importuesit e produkteve të duhanit regjistrojnë markat e tyre në Regjistrin e Markave pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit. Për vlerësimin cilësor të markave të produkteve të duhanit, të pranishme në tregun shqiptar, krijohet pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Komisioni i Ekspertëve të Degustimit të Duhan-Cigareve, i cili emërohet nga Ministri i kësaj Ministrie.

Procedura e regjistrimit, numri i anëtarëve të Komisionit të Ekspertëve të Degustimit të Duhan-Cigareve, kriteret e emërimit të tij dhe të drejtat e detyrat e këtij Komisioni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV TREGTIMI I DUHANIT TË PËRPUNUAR DHE I PRODUKTEVE TË TIJ

Neni 16

Duhani tregtohet i manipuluar, sipas cilësive, në dengje industriale dhe i fermentuar.

Neni 17

Produktet e duhanit, të prodhuesve të vendit ose të importit, të pranishme në tregun shqiptar, tregtohen vetëm me pullë fiskale, të ngjitur në ambalazhin përdorues, nën letrën e tejdukshme të paketës.

Neni 18

Personat fizikë dhe juridikë që tregtojnë duhan të përpunuar dhe produkte të tij vendosin detyrimisht në mjedisin e tregtimit tabela në gjuhën shqipe: “Cigare”, “Produkte të duhanit”, “Pirja e duhanit dëmton shëndetin”.

Neni 19

Ndalohet tregtimi i duhanit për konsum dhe i produkteve të tij:

- a. Cigare jashtë paketës (të hapura);
- b. me prejardhje dhe prodhues të panjohur;
- c. me dëmtime dhe defekte që prishin cilësinë përdoruese.

Neni 19/a¹

(Shtuar me ligjin nr. 8974, datë 21.11.2002)

Produktet e duhanit që tregtohen në Shqipëri duhet të përmbajnë në ambalazh, respektivisht etiketën e tyre, të dhëna për përmbajtjen e katranit dhe nikotinës. Këto të dhëna duhet të maten në bazë të standardeve ndërkombëtare në fuqi.

Të dhënat për katranin dhe nikotinën në paketat e cigareve duhet të shtypen në një faqe anësore të paketës, në gjuhën shqipe, me shkrim të lexueshëm qartë dhe në kontrast me sfondin, në një sipërfaqe që zë jo më pak se 10 për qind të sipërfaqes respektive të faqes anësore të paketës.

Neni 19/b

(Shtuar me ligjin nr. 8974, datë 21.11.2002; Hequr paragrafi I tretë me ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006)

Në çdo pako duhani duhet të shkruhet në gjuhën shqipe, në pjesën më të dukshme të tij, paralajmërimi i përgjithshëm “Duhani dëmton rëndë shëndetin”.

Në paketat e cigareve paralajmërimi i përgjithshëm në gjuhën shqipe “Duhani dëmton rëndë shëndetin” duhet të shkruhet në faqen e madhe ballore të paketës, ndërsa në faqen tjetër ballore duhet të shkruhet në gjuhën shqipe njëri nga paralajmërimet alternative:

- “Pirja e duhanit shkakton kancer”
- “Pirja e duhanit shkakton sëmundje të zemrës”
- “Pirja e duhanit shkakton sëmundje vdekjeprurëse”
- “Pirja e duhanit shkakton kancer, bronkit kronik dhe sëmundje të tjera të krahavorit”
- “Pirja e duhanit dëmton shëndetin e njerëzve që ju rrethojnë”
- “Mbroni fëmijët nga duhani”
- “Pirja e duhanit nga gratë shtatzëna dëmton fëmijën”.

Paralajmërimet e përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni duhet të zënë jo më pak se 10 për qind të sipërfaqes së secilës nga faqet ballore të paketës. Paralajmërimet duhet të shkruhen me shkrim të qartë dhe të lexueshëm, me shkronja të trasha dhe në kontrast me sfondin, nuk duhet të shtypen në pjesë që mund të dëmtohen nga hapja e paketës, si dhe nuk duhet të shtypen në mbështjellësen transparente ose në ndonjë mbështjellëse tjetër të jashtme.

Për produktet e tjera të duhanit, paralajmërimi i përgjithshëm i përmendur në paragrafin e

¹ Ligji 9636 datë 6.11.2006 botuar në F.Z nr. 124, datë 27.11.2006 në nenin 21 të tij shprehet: “Paragrafi i tretë i nenit 19/a dhe paragrafi i tretë i nenit 19/b të ligjit nr.8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar, shfuqizohen.”

parë duhet të shtypet në ambalazh ose të ngjitet mbi të, duke u vendosur në pjesët më të dukshme të tij, në kontrast me sfondin dhe në mënyrë që të jetë i dukshëm dhe i lexueshëm qartazi. Në çdo rast, nuk duhet të bëhet e mundur fshehja, mbulimi ose ndërprerja e tij nga pamja ose shkrime të tjera.

Neni 19/c

(Shtuar me ligjin nr. 8974, datë 21.11.2002)

Duke filluar nga data 31 mars 2003, për importuesit dhe për prodhuesit vendas ndalohet tregtimi i produkteve të duhanit që nuk plotësojnë kushtet lidhur me etiketimin, të përmendura në nenet 19/a dhe 19/b të këtij ligji, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 20

Ndalohet reklama e çdo forme të tregtimit të duhaneve dhe të produkteve të tij në median e shkruar dhe elektronike.

KREU V

AGJENCIA KOMBËTARE E DUHAN-CIGAREVE DHE FONDI DUHAN

Neni 21

(Shfuqizuar shkronja “a” e pikës 3 me ligjin nr. 8809, datë 17.5.2001; shtuar pika 5 dhe 6 me ligjin nr. 65/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar emërtesa në pikën 5 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Për nxitjen, zhvillimin dhe garancinë e prodhimit, të përpunimit dhe të tregtimit të duhanit dhe të produkteve të tij, krijohet Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve.

Kjo agjenci është institucion shtetëror me statusin e personit juridik publik, pa qëllim fitimi, në vartësi të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Për zbatimin e detyrave dhe të funksioneve që ka Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve, krijohet “Fondi i duhanit”, i cili administrohet nga kjo Agjenci.

3. Mjetet e “Fondit të duhanit” krijohen nga këto burime:

a) Shfuqizuar.

b) 60 për qind e të ardhurave që krijohen nga derdhja e gjobave, sekuestriimeve dhe sanksioneve të tjera që rrjedhin nga ky ligj. 40 për qind e të ardhurave nga gjobat, sekuestrimet dhe sanksionet të tjera derdhen në buxhetin e shtetit.

c) dhurime, ndihma dhe mjete të tjera të dhëna nga dhurues të ndryshëm dhe nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.

4. Mjetet e fondit përdoren për këto qëllime:

a) për sigurimin e farës ose të fidanëve të duhanit dhe për prodhuesit e duhanit, sipas nenit 9 të këtij ligji;

b) për politika të caktuara të shtetit për zhvillimin e sektorit të duhanit.

Fillimi i veprimtarisë, mënyra e organizimit dhe funksioni i kësaj Agjencie përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Inspektimi i zbatimit të kërkesave të detyrueshme, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, është në kompetencën e strukturës përgjegjëse për inspektimin në ushqim.

6. Inspektimi kryhet sipas ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, përveç se kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj.

KREU VI

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 22

(Shtuar togfjalësh në shkronjën “c” dhe shkronja “c/1” me ligjin nr. 8974, datë 21.11.2002; ndryshuar fjalë në shkronjat “a” dhe “c” me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009; ndryshuar me ligjin nr. 65/2013, datë 14.2.2013)

Kur nuk përbëjnë vepra penale, shkeljet e mëposhtme, të kryera nga një person fizik ose juridik, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) Tregtimi i duhanit të papërpunuar nga subjekte, në kundërshtim me nenin 12 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën nga 20 mijë deri në një milion lekë, me sekuestrimin e sasisë së duhanit si dhe/ose me propozimin drejtuar ministrit, për heqjen e licencës përkatëse.

b) Prodhimi i produkteve të duhanit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 14 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 10 mijë deri në 300 mijë lekë dhe me sekuestrimin e makinerive, të pajisjeve, të lëndës së parë, të materialeve ndihmëse dhe të prodhimit të gatshëm.

c) Tregtimi i produktit të duhanit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 19 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën nga 5 mijë deri në 20 mijë lekë dhe sekuestrimin e produkteve të duhanit.

c/1) Tregtimi i produkteve të duhanit në kundërshtim me kërkesat e neneve 19/a, 19/b dhe 19/c të këtij ligji në territorin e Republikës së Shqipërisë dënohet me konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve të duhanit.

ç) Reklama e tregtimit të duhanit, në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 200 mijë lekë deri në një milion lekë dhe heqjen e reklamave.

Masa e gjobës, në zbatim të këtij neni, është dënim kryesor. Masa e sekuestrimit të sasisë, heqjes së licencës përkatëse, sekuestrimin e makinerive, të pajisjeve, të lëndës së parë, të materialeve ndihmëse dhe të prodhimit të gatshëm, sekuestrimin e produkteve të duhanit dhe/ose heqjes e lejes përkatëse, si dhe masat e heqjes së reklamave, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “c/1” dhe “ç” të këtij neni, janë dënime plotësuese.

Neni 23

(Shtuar pika 2 me ligjin nr. 8974, datë 21.11.2002; shtuar pika 3 me ligjin nr. 10275, datë 6.5.2010; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 65/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar emërtesa në pikën 1 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Dënimet dhe masat administrative vendosen nga inspektori i strukturës përgjegjëse për inspektimin në ushqim, që mbulon fushën përkatëse, në përputhje me ligjin për inspektimin. Shqyrtimi, marrja e vendimit nga inspektori dhe ankimi ndaj tij bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

Ekzekutimi i vendimit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

2. Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe ajo e Doganave janë përgjegjëse për konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve, paketimi i të cilave nuk është në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

3. Produktet e duhanit, që kanë shërbyer si mjet për veprën penale, për të cilat është vendosur me vendim gjyqësor të formës së prerë konfiskimi, paketimi i të cilave nuk është në përputhje me kërkesat e këtij ligji, asgjësohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, me pjesëmarrjen e organeve të përmendura në pikën 2 të këtij neni.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24

Çdo akt ligjor dhe nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Dispozitë kalimtare
(Parashikuar në ligjin nr. 65/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 25
(Shtuar paragraf me ligjin nr. 10275, datë 6.5.2010)

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 14, 15, 16, 21 dhe 23 të këtij ligji.

Procedurat dhe afatet, në zbatim të pikës 3 të nenit 23 të këtij ligji, rregullohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Brendshëm.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2836, datë 18.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**